



**Government Defence
Integrity Index**



2020

Përmbledhje e shtetit:

KOSOVA



KOSOVA

Kosova po bëhet një lojtar gjithnjë e më i spikatur i sigurisë në Ballkanin Perëndimor. Miratimi në vitin 2018 i legjislacionit që hap rrygën për transformimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës në një ushtri kombëtare shkaktoi valë tronditëse në rajon, me Serbinë që akuzoi Prishtinën se “rrihte daullet e luftës”¹. Ndërkohë që kërcënimet serbe për okupim kanë dështuar të materializohen², masa/lëvizja ishte e rëndësishme në një rajon që po përjeton militarizimin spiral dhe konkurrencën e ripërtëritë të fuqive të mëdha³. Me Kosovën që deklaroi ambicien e saj për t'u bërë anëtare e NATO pasi ushtria e saj kombëtare të jetë funksionale⁴ dhe me buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes (MM) duke u rritur me gjashtë milionë euro në vitin 2019⁵, ky është një moment kritik për Kosovën.

Rritja buxhetore u pasua në vitin 2021 me një rritje tjetër prej 5% krahasuar me një vit më parë dhe vendimi i qeverisë së re për të rritur më tej buxhetin për MM me rreth 48.5% për vitin 2022, në 100 milionë €⁶. Pas vitesh lufte me korrupsionin, qeverisjen e dobët dhe mosfunksionimin politik⁷, investimet financiare në mbrojtje ngrenë rreziqe të konsiderueshme korrupsioni, veçanërisht në mungesë të qeverisjes së forcuar të mbrojtjes dhe masave mbrojtëse institucionale ndaj korrupsionit. Përderisa Kosova ka një kornizë të fortë legjislative për mbrojtjen, mbetet një boshllëk i dukshëm në zbatim, i cili ka rezultuar në mbikëqyrje të dobët parlamentare, transparencë të dobët, procedura të fshehta të prokurimit dhe një mjedis të pasigurt për sinjalizuesit. Dështimi për të korrigjuar këto çështje mund të bëjë që shpresat kosovare për një ushtri kombëtare profesionale të shuhet përmes menaxhimit të keq financiar dhe korrupsionit, i cili mund të dëmtojë në mënyrë të pariparueshme ambicien në rritje rajonale dhe ndërkombëtare të Kosovës.

Anëtar i Partneritetit për Qeverisje të Hapur	Jo
Konventa e OKB kundër Korrupsionit	Nuk është ratifikuar.
Traktati i Tregtisë së Armëve	Nuk është ratifikuar.

Përmbledhje e Evropës Qendrore dhe Lindore

Ndërsa shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore po integrohen gjithnjë e më shumë me BE-në dhe NATO-n përmes anëtarësimit dhe partneriteteve, ato janë gati të luajnë një rol kyç në të ardhmen e kontinentit, dhe në veçanti në vendimet e tij të sigurisë dhe mbrojtjes. Megjithatë, një kombinim i perceptimeve akute të kërcënimit, rritja e buxheteve të mbrojtjes dhe sfidave ndaj institucioneve demokratike i bëjnë shtetet në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe në Kaukaz veçanërisht të prekshme ndaj pengesave në qeverisjen e mbrojtjes, gjë që mund të kërcënojë përparimin e bërë gjatë dekadave të fundit. Tashmë, qeveritë autoritare, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor dhe Evropën Qendrore, kanë mbikryrur kthimin e ndjeshëm prapa në demokraci e që ka minuar cilësinë e qeverisjes së mbrojtjes dhe ka rritur rrezikun e korrupsionit në këtë sektor. Konfliktet e vazhdueshme dhe të ngrira në Ukrainë, Moldavi, Armeni dhe Azerbajxhan, të kombinuara me përpjekjet ruse për të ushtruar ndikim mbi rajonin përmes ndërhyrjeve zgjedhore, dezinformimit dhe korrupsionit, kontribuojnë në një situatë delikate të sigurisë në një rajon strategjikisht kritik.

Kjo do të testojë cilësinë e qeverisjes së mbrojtjes në të gjithë rajonin, i cili edhe pse mjaft i fuqishëm, ka boshllëqe dhe mangësi të vazhdueshme që duhet të adresohen. Mbikëqyrja e dobët parlamentare dhe harmonizimi në rritje midis ekzekutivit dhe legjislativit po dëmton cilësinë e kontrollit të jashtëm, ndërkohë që prokurimi vazhdon të mbulohet me fshehtësi dhe të përjashtohet nga procedurat standarde të kontraktimit dhe raportimit. Po ashtu, qasja në informacion dhe sistemet e mbrojtjes së sinjalizuesve po kërcënohen gjithnjë e më shumë dhe antikorrupsioni mbetet i integruar keq në operacionet ushtarake.



1 DW, "Kosovo Legislature Approves Creation of National Army", *Deutsche Welle*, 14 December 2018.

2 Andrew Rettman, "Serbia Threatens to Invade Kosovo, Stirring Bad Memories", *EU Observer*, 6 December 2018.

3 Sasa Kulenovic, "Western Balkans and the Return to Arms: Can the EU Stabilize the Region?", *Vocal Europe*, Policy Paper, 3 October 2019.

4 Vukašin Živković, "NATO Perspective of Kosovo and Bosnia and Herzegovina", *European Western Balkans*, 8 February 2019.

5 Die Morina, "Kosovo Hikes Defence Budget to Fund New Army", *Balkan Insight*, 8 February 2019.

6 Government's 36th meeting, dated 22 Sep 2021.

7 Freedom House, "Kosovo Country Report", Freedom House, Washington DC, 2020, C2.



KOSOVA

Rezultatet e përgjithshme

Madhësia e brezit të ngjyrave korrespondon me numrin e vendeve që bëjnë pjesë në atë kategori.

REZULTATI I KOSOVËS RREZIKU I LARTË


D

42



A 83-100 > SHUMË E ULËT B 67-82 > E ULËT C 50-66 > E MODERUAR D 33-49 > E LARTË E 17-32 > SHUMË E LARTË F 0-16 > KRITIKE

Krahasimi i riskut





Mbikëqyrja Parlamentare

Mbikëqyrja legjislativë e buxhetit (Anketa e Hapur Buxhetore, 2019)	E pa vlerësuar
Shpenzimet ushtarake si pjesë e shpenzimeve qeveritare (SIPRI, 2020)	3.2%
Anëtarët të komisionit me ekspertizë të mbrojtjes %	36% (4/11)
# i takimeve/vit	9 (2019); 24 (2018); 17 (2017)
Rishikimi/përditësimi i fundit i politikës së mbrojtjes	N/A

Blokimi i gjatë politik pas zgjedhjeve në vitin 2017 dhe 2019 ka ndikuar rëndë aktivitetet legjislativë dhe mbikëqyrëse të Kuvendit Kombëtar.⁸ Konteksti shumë i polarizuar politik i Kosovës në të cilin anëtarët e Kuvendit mungojnë shpesh, ndonjëherë për shkak të bojkotit, ka rezultuar në dështimin e rregullt të arritjes së kuorumit, duke çuar në vonesë në legjislacionin dhe ushtrimin e mbikëqyrjes.⁹ Siç e ka theksuar rregullisht Komisioni Evropian, mbikëqyrja e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) vazhdon të jetë e pamjaftueshme.¹⁰ Edhe pse legjislacioni i ri që përmirëson procedurat për kontrollin demokratik të FSK hyri në fuqi në vitin 2019¹¹, siç qëndrojnë gjërat, mekanizmat ekzistues të mbikëqyrjes parlamentare të Kosovës janë të dobët. Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, i riemërtuar së fundmi, duke zëvendësuar Komisionin për Çështjet e Brendshme, Sigurisë dhe Mbikëqyrjes, është përgjegjës për shqyrtimin e politikës së mbrojtjes.¹² Megjithatë, pritet të mbikëqyrë Ministrinë e Mbrojtjes (MM), FSK, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Inspektoratin Policor, një fushëveprim i gjerë, veçanërisht duke pasur parasysh mungesën e resurseve dhe ekspertizës së komisionit.¹³ Për më tepër, zbulimet e lidhjeve të ngushta politike ndërmjet anëtarëve të komisionit dhe udhëheqjes së FSK ngrënë pikëpyetje mbi paanshmërinë e komisionit. Në tre vitet e fundit, komisioni ka dështuar të nisë një hetim të vetëm në këtë sektor dhe thjesht ka shqyrtuar projektligjet.¹⁴ Gjithashtu nuk ka dëshmi se komisioni shqyrtonte raportet e auditimit të brendshëm, pavarësisht se njësia e auditimit të brendshëm të MM kryen afërsisht tetë auditime në vit. Megjithatë, në vitin 2021, komisioni ka shqyrtuar raportin vjetor të performancës së MM, i cili është paraqitur nga Ministria.¹⁵ Së fundi, sa i përket funksioneve të auditimit të jashtëm, duhet theksuar se raportet e auditimit të jashtëm nuk i dorëzohen komisionit të mbrojtjes dhe përkundrazi shqyrtohen nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike.¹⁶ Zyra Kombëtare e Auditimit, e cila kryen një kontroll të jashtëm të shpenzimeve të mbrojtjes, është relativisht aktive në auditimin e sektorit. Megjithatë, aftësia e tyre për të zbatuar rekomandimet e tyre është e kufizuar.¹⁷

Transparenca financiare

Qasja në informacion në lidhje me mbrojtjen normat e përgjigjes	(1) % i është dhënë qasje e plotë ose e pjesshme: 100%
	(2) # subjekt i prapambetjes: 0
Ankesa në lidhje me mbrojtjen drejtuar Avokatit të Popullit/komisionerit #	0
A ka autoritet komisioneri mbi MM?	Po
Raportet e auditimit për mbrojtjen (2018-2020) #	1 (2018); 1 (2019); 1 (2020)
Indeksi i Buxhetit të Hapur (IBP, 2019)	E pa vlerësuar
Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit (RSF, 2021)	Vendi i 78 nga 180

Kosovo ka një rekord të pabarabartë sa i përket transparencës së qeverisë dhe qasjes në informacion.¹⁸ Ndonëse renditet e dyta më e larta në Ballkanin Perëndimor për kërkesat për informacion që dorëzohen dhe përgjigjen pozitivisht, me 56%, shifra mbetet e ulët në nivel ndërkombëtar.¹⁹ Ligji i Kosovës për Qasje Publike në Informacion daton në vitin 2010 dhe u plotësua me Ligjin e ri për Qasje në Dokumente Publike në vitin 2019.²⁰ Ai konsiderohet gjerësisht si një nga kornizat më të mira legjislativë në rajon, megjithatë, kriteret e klasifikimit të informacionit janë mjaft të gjera²¹ dhe zbatimi i tij në sektorin e mbrojtjes mbetet i paplotë.²² Në përgjithësi, vonesat në dhënie të informacionit janë të shpeshta dhe informacioni i lëshuar mund të jetë sipërfaqësor ose i redaktuar në mënyrë arbitrare. Ekziston një proces i ankesave dhe një Avokat i Popullit i cili mund t'i rekomandojë institucionet që t'u japin qasje pas një refuzimi, megjithëse një hetim i BIRN ka zbuluar se vetëm 45% e kërkesave të tilla kanë rezultuar në qasje në dokumentet e kërkuara.²³ Megjithatë, duhet theksuar se sa i përket mbrojtjes, të gjitha kërkesat për qasje në informata janë përgjigjur dhe asnjë rast nuk i është dërguar Avokatit të Popullit.²⁴ Megjithatë, është bërë njëfarë progresi në lidhje me transparencën buxhetore. Buxheti i mbrojtjes përfshin një ndarje të linjave të ndryshme të shpenzimeve, duke përfshirë shpenzimet kapitale, të tilla si ndërtimi, prokurimi dhe blerjet.²⁵ Kjo plotësohet nga një portal online i planifikimit të prokurimit (e-prokurimi) ku autoritetet kontraktore janë të detyruara të publikojnë detaje për kontratat e paklasifikuara që lidhen me mallrat, shërbimet dhe shërbimet komunale.²⁶ Megjithatë, pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve buxhetore, veçanërisht të lidhura me shpenzimet kapitale, konsiderohen të klasifikuara, duke i përjashtuar këto kontrata nga publikimi në portal dhe duke kufizuar mbikëqyrjen.

8 Freedom House, 'Kosovo,' C1.

9 European Commission, 'Kosovo 2019 Report', Commission Staff Working Document, 216 Final, Brussels 29 May 2019, p. 6.

10 European Commission, 'Kosovo 2019', p. 7.

11 See Law No. 06/L-122 on Ministry of Defence, Law No. 06/L-123 on Kosovo Security Force, Article 15, 2019.

12 National Assembly, 'Committee on Security and Defence Affairs'.

13 Plator Avdiu and Skënder Perteshi, 'Monitoring and Assessing Report: Monitoring and Assessing the Integrity and Internal Governance in the Ministry of Kosovo Security Force and the Kosovo Police', (Pristina: Kosovar Centre for Security Studies, 2016), p. 44.

14 European Commission, 'Kosovo 2019 Report'.

15 Republic of Kosovo, 'VIII Legislature – Spring Session of the Committee on Security and Defence, Meeting No. 3', 5 May 2021.

16 The Committee for the Supervision of Public Finance's last defence review was on 12 June 2020.

17 National Audit Office, '2018 Audit Report on the Ministry of Defence', 2018.

18 Balkan Investigative Reporting Network, *Freedom of Information and Journalists in the Western Balkans: One Step Forward, Two Steps Back*, Sarajevo, 2019, pp. 24-25.

19 Balkan Investigative Reporting Network, 'Western Balkans Have Yet to Embrace Freedom of Information', BIRN, 26 December 2019.

20 Government of the Republic of Kosovo, 'Law No. 06/L-081 On Access to Public Documents', *Official Gazette of the Republic of Kosovo*, no. 13, 4 July 2019.

21 Republic of Kosovo, 'Law No. 06/L-081', Article 17; 'Law 03/L-178', Article 4.

22 Furtuna Sheremeti, 'Kosovar Journalists Need to Demand Implementation of their Access to Information', *Kosovo 2.0*, 31 January 2017.

23 BIRN, *Freedom of Information*, p. 26.

24 In 2020 there were 11 RAI on non-classified information, 0 delays, 0 rejections, according to the response received by MoD to the KDI/TIK request for access to public documents dated 26th of September 2021.

25 Government of the Republic of Kosovo, 'Law on the Budget Appropriations of the Republic of Kosovo for Year 2020', *Official Gazette of the Republic of Kosovo*, No. 1, 19 March 2020, p. 64 and p. 100.

26 Public Procurement Regulatory Commission of the Republic of Kosovo, 'E-Notices Procurement'.



KOSOVA

Korniza e Etikës së Personelit

Legjislati i sinjalizimit	Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (2018)
# rastet e sinjalizuesve të sektorit të mbrojtjes	Të dhënat nuk janë të disponueshme publikisht
# Shkeljet e kodit të sjelljes	Ushtarak: Të dhënat nuk janë të disponueshme publikisht Civile: Të dhënat nuk janë të disponueshme publikisht
Sistemi i zbulimit financiar	# dorëzuar: Të dhënat nuk janë të disponueshme publikisht # i shkeljeve: Të dhënat nuk janë të disponueshme publikisht

Në fund të vitit 2018, Ushtria e sapoformuar e Kosovës miratoi Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve që mbulon edhe organet publike, duke përfshirë institucionet e mbrojtjes dhe ato ushtarake.²⁷ Legjislati i Kosovës konsiderohet gjerësisht si një nga më të kompletuarit dhe më të mirët në Evropë, megjithatë, në praktikë, prioritizimi dhe zbatimi i tij mbetet problem.²⁸ Në sektor ka mungesë të vetëdijes për mekanizmat përmes të cilëve mund të bëhen pretendime. Ekzistojnë gjithashtu shqetësime të rëndësishme se sa efektivisht do të zbatohet ligji dhe shkalla në të cilën garantohet mbrojtja për ata që raportojnë keqëbërje, veçanërisht në një fushë kaq të ndjeshme si mbrojtja. Diku tjetër, dispozitat kundër korrupsionit përmenden vetëm në kodet e sjelljes. Kodi i Etikës për Forcën e Sigurisë së Kosovës i referohet masave për ndërtimin e integritetit dhe konfliktit të interesit.²⁹ Megjithatë, ai nuk ofron udhëzime të qarta se si personeli duhet t'i trajtojë këto çështje dhe nuk ka asnjë provë të disponueshme publikisht që një kod i tillë ekziston për personelin civil. Në mënyrë të ngjashme, përveç një angazhimi në Planin e Integritetit 2019-2022 për Ministrinë e Mbrojtjes³⁰, nuk ka asnjë dëshmi se trajnimi i rregullt kundër korrupsionit kryhet për personelin në këtë sektor. Ndërsa angazhimi në Planin e Integritetit është pozitiv, nevojiten dëshmi të zbatimit që ai të konsiderohet efektiv.

Operacionet

Personeli total i forcave të armatosura (Banka Botërore, 2018)	N/A
Trupat e dislokuara në operacione #	N/A

Kosova aktualisht nuk merr pjesë në asnjë operacion ushtarak ndërkombëtar, pasi Forca e Sigurisë së Kosovës është kryesisht një grup i mbrojtjes civile. Megjithatë, me transformimin e tyre gradual në forca të armatosura të plota dhe me synimin e vendit për t'u bërë një vend anëtar i NATO sapo të përfundojë ky proces³¹, perspektiva e vendosjes së trupave kosovare jashtë vendit në të ardhmen e afërt po rritet. Pa një theks të vazhdueshëm në përmirësimin e vetëdijes për rrezikun e korrupsionit në operacione, trupat kosovare do të jenë të përgatitura dobët për të luftuar praktikat korruptive që mund të rrezikojnë misionin e tyre. Kosova aktualisht nuk ka një strategji të mbrojtjes dhe asnjë nga dokumentet ekzistuese strategjike, përfshirë Planin e Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes 2019-2022³², nuk njohin korrupsionin si një çështje strategjike për suksesin e operacioneve. Kjo është pjesërisht për shkak se FSK nuk merr pjesë në operacione. Megjithatë, një forcë operationale ndërkombëtare pa udhëzime kundër korrupsionit për operacione apo trajnim të institucionalizuar për rreziqet e korrupsionit, rrezikon suksesin e misioneve të saj. Megjithatë, duhet të theksohet se personeli i FSK merr disa trajnime për çështjet e korrupsionit, ndonëse kjo ofrohet nga partnerët bilateralë si Britania e Madhe, Norvegjia dhe NATO dhe ende nuk janë integruar plotësisht në pakon e trajnimit të Forcave të Armatosura të Kosovës.

²⁷ Assembly of the Republic of Kosovo, 'Law No. 06/L-085 On Protection of Whistleblowers'.

²⁸ Xhorxhina Bami, 'For Whistleblowers in Kosovo, Protection on Paper but not in Practice', *BIRN*, 27 July 2020.

²⁹ Kosovo Security Force, 'Code of Ethics for KSF', 2019.

³⁰ Ministry of Defence, 'Integrity Plan for 2019-2022', 2019.

³¹ Živković, 'NATO Perspective of Kosovo and Bosnia and Herzegovina.'

³² Ministry of Defence, 'Integrity Plan for 2019-2022', 2019.



Prokurimi i Mbrojtjes

Shpenzimet ushtarake (milion USD) (SIPRI, 2020)	77
Konkursi i hapur në prokurimin e mbrojtjes (%)	78.5% (procedurat e hapura jo të klasifikuara); 9.2% (të kufizuara të paklasifikuara); 12% (të klasifikuara)
Eksportet kryesore të mbrojtjes (në)	N/A
Importet kryesore të mbrojtjes (nga)	N/A

Shpenzimet ushtarake përfaqësojnë një përqindje relativisht të vogël të BPV të Kosovës, por po rriten me krijimin e planeve për ushtrinë e re kombëtare.³³ Kjo do të nënkuptojë në mënyrë të pashmangshme një rritje të mprehtë të kërkesave dhe iniciativave për prokurimin e mbrojtjes për pajisjen dhe profesionalizimin e forcës së re. Megjithatë, prokurimi publik në Kosovë mbetet i cenueshëm ndaj korrupsionit, me institucione mbikëqyrëse me burime të dobëta dhe monitorim të pamjaftueshëm të kontratave.³⁴ Këto çështje janë evidente edhe në sektorin e mbrojtjes, i cili vuan nga nivele të larta të paqartësisë dhe sekretit financiar në procedurat e prokurimit. Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) nuk

publikojnë planet e prokurimit publik, duke e bërë të vështirë përcaktimin se si vendosen vendimet dhe kërkesat. Plani Gjithëpërfshirës i Tranzicionit i FSK (2019-2027) përshkruan planin e tyre të blerjes³⁵, megjithatë dokumenti publikohet në një formë të përmblëdhur dhe përjashton shumicën e detajeve dhe arsyetimeve. Fshehtësia në procesin e planifikimit të blerjeve dhe në përpunimin e kërkesave të prokurimit është komplikuar më tej nga mbikëqyrja e dobët e vetë procedurave. Korniza ligjore e Kosovës ende nuk është përafuar me Direktivën e BE për Prokurimin e Mbrojtjes, edhe pse rregulloret specifike u prezantuan në vitin 2019 për të menaxhuar siç duhet prokurimin e mbrojtjes dhe sigurisë, duke përfshirë ato që i nënshtrohen klasifikimit.³⁶ Institucionet mbikëqyrëse gjithashtu vuajnë nga kapaciteti i dobët. Organi Shqyrtues i Prokurimit është përgjegjës për zbatimin e procedurave të shqyrtimit të prokurimit dhe është i autorizuar të shqyrtojë dhe diskualifikojë operatorët nga pjesëmarrja me kërkesë me shkrim të autoritetit kontraktues.³⁷ Megjithatë, ka mungesë të personelit kronik dhe dy nga pesë anëtarët e bordit të tyre janë aktualisht të suspenduar për shkak të aktakuzës së tyre në një rast korrupsioni.³⁸

³³ 2018 budget – 53,667,393EUR, 2019 budget – 58,688,060 (+9.35%), 2020 budget – 63,602,303 EUR (+8.37%), 2021 budget – 67,317,674 EUR (+5.84% points), Ministry of Finance of the Republic of Kosovo, 'Law on Budgets, Morina, 'Kosovo Hikes Defence Budget.'

³⁴ European Commission, 'Kosovo 2019', p. 63.

³⁵ Ministry of Defence, 'Kosovo Security Force Comprehensive Transition Plan 2019-2027', 2019.

³⁶ Government of the Republic of Kosovo, 'Regulation (GRK) No. 03/2019: On Procurement for Defense and Security Purposes', Pristina, March 2019.

³⁷ Government of the Republic of Kosovo, 'Law on Public Procurement: Article 99 - Functions and Powers of the Procurement Review Body', Pristina, 2011.

³⁸ European Commission, 'Kosovo 2019', p. 65.

Verzióni 1.0, Tetor 2021

Mbledhja e të dhënave të GDI-së për Kosovën është kryer nga shtatori 2018 deri në nëntor 2019. Diskutimi narrativ në këtë përmbljedhje të GDI-së është prodhuar më vonë me informacionin më të fundit të disponueshëm për vendin, të cilat mund të mos pasqyrohen në vlerësimet ose pikët e GDI-së për vendin.



KOSOVA 2020 GDI Scorecard

Grada Rezultati

Rreziku politik		D	49
Q1	Shqyrtimi legjislativ	D	42
Q2	Komisioni i Mbrojtjes	E	17
Q3	Debati për politikën e mbrojtjes	F	8
Q4	Angazhimi i OSHC-ve	D	42
Q5	Konventat: UNCAC / OECD	F	0
Q6	Debat publik	C	50
Q7	Politika antikorupsion	A	88
Q8	Njësitë e pajtueshmërisë dhe etikës	B	75
Q9	Besimi i publikut tek institucionet	NS	
Q10	Vlerësimet e rrezikut	A	83
Q11	Planifikimi i blerjeve	D	33
Q12	Transparenca dhe detajet e buxhetit	B	75
Q13	Shqyrtimi i buxhetit	E	25
Q14	Disponueshmëria e buxhetit	C	58
Q15	Të ardhurat e mbrojtjes	B	67
Q16	Auditimi i brendshëm	D	44
Q17	Auditimi i jashtëm	B	69
Q18	Burime natyrore	B	67
Q19	Lidhjet e krimit të organizuar	B	75
Q20	Lufta kundër krimit të organizuar	B	67
Q21	Mbikëqyrja e shërbimeve të inteligjencës	A	88
Q22	Rekrutimi i shërbimeve të inteligjencës	C	50
Q23	Kontrollet e eksportit (ATT)	F	0
Q76	Lobimi	F	0
Rreziku financiar		D	49
Q24	Kontrollet e asgjësimit të aseteve	E	25
Q25	Shqyrtimi i shkatërrimit të aseteve	B	67
Q26	Shpenzime sekrete	F	0
Q27	Qasja legjislative në informacion	E	25
Q28	Auditimi sekret i programit	F	0
Q29	Shpenzimet jashtë buxhetit	B	75
Q30	Qasja në informacion	D	38
Q31	Pronësia përfituese	A	100
Q32	Shqyrtimi i biznesit në pronësi ushtarake	A	100
Q33	Ndërmarrje private e paautorizuar	C	50
Q77	Shpenzimet e mbrojtjes	C	56
Rreziku i personelit		C	56
Q34	Angazhimi publik për integritet	E	25
Q35	Masat disiplinore për personelin	C	50
Q36	Sinjalizimi	C	50
Q37	Pozicionet me rrezik të lartë	C	50
Q38	Numri i personelit	B	67
Q39	Normat e pagesës dhe shtesat	E	25
Q40	Sistemi i pagesave	A	83
Q41	Emërimet objektive	C	50
Q42	Promovimet objektive	B	81
Q43	Ryshfeti për të shmangur rekrutimin	NA	
Q44	Ryshfeti për postimet e preferuara	B	67
Q45	Zinxhirët e komandës dhe pagesës	A	100
Q46	Kodi i Sjelljes ushtarake	C	58

REZULTATI I PËRGJITHSHËM I VENDIT

RREZIKU I LARTË



KLASA E RREZIKUT

A	83-100	Shumë e ulët
B	67-82	E ulët
C	50-66	E moderuar
D	33-49	E lartë
E	17-32	Shumë e lartë
F	0-16	Kritike



Rreziku i personelit		C	56
Q47	Kodi civil i sjelljes	NEI	
Q48	Trajnime kundër korrupsionit	NEI	
Q49	Ndjekja penale e korrupsionit	D	33
Q50	Pagesat për lehtësime	C	50

Rreziku operativ		E	19
Q51	Doktrina ushtarake	F	0
Q52	Trajnime operacionale	B	75
Q53	Planifikimet ushtarake përpara	F	0
Q54	Monitorimi i korrupsionit në operime	NEI	
Q55	Kontrollet në kontraktime	F	0
Q56	Kontraktorët privat të ushtrisë	NS	

Procurement Risk		D	37
Q57	Legjislacioni për prokurim	D	38
Q58	Cikli i prokurimit	D	33
Q59	Mekanizmat për mbikëqyrje të prokurimit	C	50
Q60	Blerjet potencialisht të mbyllura	E	25
Q61	Blerjet aktualisht të mbyllura	E	25
Q62	Standardet e pajtueshmërisë së biznesit	D	38
Q63	Kriteret/Kërkesat e prokurimeve	D	33
Q64	Konkurrenca në prokurim	C	50
Q65	Kontrollet e bordit të tenderëve	B	75
Q66	Kontrollet kundër marrëveshjeve të fshehta	D	44
Q67	Dhënia dhe përmbushja e kontratave	D	38
Q68	Mekanizmat për ankimim	A	83
Q69	Sanksionet ndaj operatorëve	B	67
Q70	Kontratat në operacione të jashtme	F	0
Q71	Monitorimi i kontratave në operacionet e jashtme	F	0
Q72	Konkurrenca në operacionet e jashtme	F	0
Q73	Ajentët dhe ndërmjetësuesit	C	50
Q74	Pakot financiare	E	25
Q75	Presioni publik në blerje	NS	

ÇELËSI	NEI	Nuk ka informacion të mjaftueshëm për të shënuar tregues
	NS	Treguesi nuk vlerësohet për asnjë vend
	NA	Nuk aplikohet



ti-defence.org/gdi

GDI@transparency.org

Transparency International UK
Registered charity number 1112842
Company number 2903386

Transparency International Mbrojtja dhe Siguria (TI-DS) është një iniciativë globale e rrjetit tematik të Transparency International. Është një ent i pavarur dhe nuk përfaqëson asnjë kapitull kombëtar të TI. TI-DS është i vetmi përgjegjës për përsëritjen e Indeksit të Integritetit të Mbrojtjes së Qeverisë (GDI) për vitin 2020 dhe të gjitha produkteve të lidhura, duke përfshirë Përmbledhjet GDI për secilin shtet.

Mirënjohje

Dëshirojmë të falënderojmë Zyrën e Komonuelthit dhe Zhvillimit të Jashtëm të Mbretërisë së Bashkuar (FCDO) dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës për mbështetjen e tyre bujare financiare për prodhimin e Indeksit të Integritetit të Mbrojtjes së Qeverisë. Falënderimet janë gjithashtu për shumë vlerësues të vendeve dhe rishikues kolegë që kontribuan në të dhënat themelore për këtë indeks.

Series editor: **Stephanie Trapnell**, *Senior Advisor*

Author: **Matthew Steadman**, *Research Officer*

Project Manager: **Michael Ofori-Mensah**, *Head of Research*

Design: **Arnold and Pearn**



Foreign, Commonwealth
& Development Office



Ministry of Foreign Affairs of the
Netherlands